KLUBI SHQIPTAR I KUMANOVËS (1909)

Kudret FERIZI

Universiteti i Tetovës

Abstrakt

Në punimin në vijim do të trajtojmë një segmenti interesant të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, atë të arsimit dhe kulturës, konkretisht rreth organizimit dhe funksionimit të klubit shqiptar të Kumanovës (1909). Shkaku se përse e kemi zgjedhur këtë temë është që të kuptojmë më në detaje funksionimin e jetës arsimore e kulturore në trojet shqiptare në Perandorinë Osmane në fillim të shek. XX, kryesisht në qytetin e Kumanovës dhe rolin që kishte klubi shqiptar i Kumanovës e edhe vetë Lëvizja Nacionaliste Shqiptare për shqiptarët e këtij qyteti dhe shqiptarët në përgjithësi.

Rritja e vetëdijes kombëtare në Shqipëri në fillim të shekullit XX, përkoi me zhvillimin e lëvizjes xhonturke në Perandorinë Osmane. Në rrugën e realizimit të synimeve të kësaj politike, Lëvizja Kombëtare Shqiptare sigurisht që do të takohej me lëvizjet xhonturke, dhe kështu ndodhi.

Hyrje

Në punimin në vijim do të trajtojmë një segmenti interesant të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, atë të arsimit dhe kulturës, konkretisht rreth organizimit dhe funksionimit të klubit shqiptar të Kumanovës (1909) dhe mbi drejtuesin e atij klubi, rilindësin e shquar Jashar Erebara. Kryengritjen xhonturke, lëvizjen nacionaliste shqiptare, hapjen e klubeve e komiteteve të reja, veprimtarinë e Jashar Erebarës si dhe çështje të ngjajshme do t'i shtjellojmë në vijim. Lëvizjet politike dhe nacionaliste ishin karakteristikë e fillim shek. XX-të në Evropë në përgjithësi e në Perandorinë Osmane në veçanti të cilat në thelb kishin orientim oksidental dhe e arritën qëllimin e tyre me ndryshimin e pushteteve autokratike, që në rastin tonë kemi Lëvizjen xhonturke e cila me ndihmën e lobeve të shteteve evropiane perëndimore nga jashtë vendit dhe lëvizjeve nacionaliste kombëtare nga mbrenda vendit arriti që ta rrëzoj nga pushteti mbi 32 vjeçar Sulltan Abdylhamidin II.

Shkaku se përse e kemi zgjedhur këtë temë është që të kuptojmë më në detaje funksionimin e jetës arsimore e kulturore në trojet shqiptare në Perandorinë Osmane në fillim të shek. XX, kryesisht në qytetin e Kumanovës dhe rolin që kishte klubi shqiptar i Kumanovës e edhe vetë Lëvizja Nacionaliste Shqiptare për shqiptarët e këtij qyteti dhe shqiptarët në përgjithësi.

Si studimin paraprak mbi këtë temë kemi librin "Veprimtaria e Klubit të Shkupit" të Ramiz Abdylit, "Variacione historike" nga Sevdail Demiri, artikuj si "Ndikimi i revolucionit xhonturk në nacionalizmin shqiptar" e "Komiteti Bashkim dhe Përparim dhe shqiptarët", të Gentrit Smakajt të botuara në revista të ndryshme si "Kosova", "Studime historike" etj.

Metodat të cilat i kemi përdorur gjatë këtij punimi janë: metoda induktive, metoda deduktive, metoda historike dhe metoda komparative.

Qëllimi se përse e kemi zgjedhur këtë temë është që të hidhet dritë mbi këtë klub shqiptar në zonën më lindore etnike shqiptare dhe mbi rolin dhe funksionin e shkollës së parë shqipe në këtë qytet e hapur në kuadër të këtij klubi.

Hipotezat të cilat na lindin gjatë këtij punimi janë se sa shqiptarët ishin të kënaqur me gjendjen e re politike shoqërore që u krijua si rezultat i revolucionit xhonturk në korrik të vitit 1908 si dhe cili ishte shkaku që dërgoi deri në ndarje e armiqësi në mes politikave të lëvizjes nacionaliste shqiptare dhe politikave të pushtetit të ri xhonturk, duke e ditur që shqiptarët kishin rol kyç në këtë revolucion.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp114

I. Revolucioni xhonturk (1908) dhe shqiptarët

Lëvizja e turqve të rinj, ose siç thirret zakonisht e *"*xhonturqve*"*, lindi në vitin 1889, pikërisht në qindvjetorin e Revolucionit Francez. Disa studentë të Shkollës së Mjekësisë Ushtarake në Stamboll krijuan një grup të fshehtë kundër regjimit të sulltan Abdylhamitit dhe e quajtën Komiteti i Bashkimit Osman. Grupi u organizua në celula sipas modelit të karbonarëve italianë, ose të nihilistëve rusë. Ndërmjet ithtarëve të parë të grupit ishin disa arabë të krishterë, shqiptarë, kurd dhe turq. Në mbledhjet e celulave përkujtohej Revolucioni Borgjez Francez, recitoheshin vjersha të Namik Qemalit dhe analizohej gjendja e perandorisë. Duke qenë se kishin fare pak përvojë, studentët xhonturq kërkonin që të vinin në praktikë idetë që kishin mësuar në bankat e shkollës. Ky fakt ka një domethënie të madhe, sepse mjeshtëria ushtarake dhe mjekësia ishin në të vërtetë dy sektorë të shtetit, në të cilët reformat për modernizim kishin filluar të bëheshin qysh në shekullin XVIII dhe për këtë arsye shpeshherë ecën shumë më përpara se pjesa tjetër e shoqërisë osmane. Në të gjithë historinë e lëvizjes xhonturke oficerët dhe mjekët luajtën një rol të dorës së parë.[1]

Pas një fillimi jo të vrullshëm, Komiteti nisi të përhapej në perandori, së pari ndërmjet studentëve të shkollave të larta të kryeqytetit, si Akademia Ushtarake, Shkolla e Veterinarisë, Shkolla e Administrimit, Akademia Detare, etj. Por ai filloi të rekrutojë anëtarë edhe ndërmjet oficerëve që tanimë punonin në ushtri, si dhe ndërmjet ulemave.

Në vitin 1895 dolën në pah si udhëheqës të opozitës në mërgim dy intelektualë xhonturq: Ahmet Rizai i cili po atë vit filloi ta botojë gazetën Meşveret (Këshillimi), dhe Murat Mizanxhiu i cili kishte filluar ta botojë një gazetë tjetër të quajtur Mizan. Formula e gazetës *Meşveret* ishte "Rend e Përparim".[2]

Gjatë viteve 1895-1897 u shtua me shpejtësi veprimtaria e xhonturqve, si brenda ashtu edhe jashtë perandorisë. Në Europë i gjithë opinioni publik, i cili ishte zemëruar së tepërmi me Abdylhamitin për shkak të politikës së shtypjes së armenëve, përkrahte opozitën xhonturke. Në Perandorinë Osmane, sidomos falë zyrave postare të huaja, arrinin që të futeshin libra të letërsisë revolucionare që botoheshin në Paris ose Gjenevë, si dhe gazeta, broshura dhe pamflete të ndryshme.

Qendra e veprimtarisë xhonturke ishte në Paris, ku u mbajt Kongresi i vitit 1902. Ky kongres që u mblodh me nismën e djemve të Mahmut Pashë Damadit me qëllim që të bashkonte lëvizjen xhonturke, në të vërtetë përjetësoi ndarjen e tij. Të tërë delegatët ishin të një mendjeje se për të kryer ndryshimet politike të kërkuara në Perandorinë Osmane, ishte e nevojshme përfshirja e ushtrisë, sepse vetëm me propagandë kjo gjë nuk mund të arrihej kurrë. Por ata ndaheshin kur vinte puna te ndërhyrja e Europës për të rivendosur Kushtetutën. Delegatët joturq, sidomos armenët dhe Sabaudini me shokët kërkuan që në valle të futeshin Fuqitë evropiane, si Franca dhe Anglia. Ahmet Rizai dhe ithtarët e tij kundërshtonin me ngulm dhe theksonin se ndërhyrja e Fuqive evropiane paraqiste rrezik tepër të madh për perandorinë. Ata mbetën në pakicë, por nuk pranuan të ndiqnin shumicën. Kësisoj, lëvizja xhonturke mbeti e ndarë në dy fraksione: fraksioni i Sabahudinit* dhe fraksioni i Ahmet Rizait**.[3]

Në të njëjtën kohë, Selaniku ishte qyteti ku mateshin shkollat e bashkësive të ndryshme. Mundësitë më të mira për shkollim i kishin hebrenjtë, falë shkollave të Aleancës Universale Izraelite. Arsim të përparuar kishin edhe grekët, bullgarët dhe turqit. Zhvillimi ekonomik i

[1] Mantran, Robert. 2004. *Historia e Perandorisë Osmane*- përktheu Asti Papa. Tiranë: Dituria, f. 527.

[2] *Po aty,* f. 528.

[*] **Princi Sabahudin (1877-1948)** ishte një figurë e rëndësishme osmane dhe mendimtar liberal, i cili konsiderohet si një nga themeluesit e lëvizjes xhonturke. Ai promovoi reforma demokratike dhe decentralizimin e Perandorisë Osmane, duke kundërshtuar absolutizmin e sulltan Abdyl Hamidit II. Ndryshe nga një pjesë e xhonturqve që ishin më autoritarë, Princi Sabahudin ishte për liri individuale dhe vetëqeverisje lokale

[**] **Ahmet Rizai (1859-1930)** ishte një mendimtar, politikan dhe reformator osman, një nga figurat kryesore të lëvizjes xhonturke. Ai ishte përfaqësues i krahut që mbështeste **centralizimine pushtetit** dhe **reforma graduale.**

[3] *Po aty*, f. 529.

qytetit në pjesën e dytë të shekullit XIX bëri që të dallohet edhe bashkësia myslimane, ku mbizotëronin tregtarët dhe nëpunësit. Pikërisht në këto rrethana, në gusht 1906, u krijua Komiteti Osman i Lirisë.[4]

Fillimisht ai përbëhej nga dhjetë anëtarë, ndërmjet të cilëve të binin në sy disa militantë, që luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen xhonturke pas vitit 1908, si Talati, i cili atëherë ishte nëpunës në Drejtorinë e Postave të Selanikut. Komiteti, i organizuar në celula, rekrutoi shumë shpejt mjaft persona në shoqërinë maqedonase. Militantët ishin oficerë ose nëpunës, më të shumtët të rinj, shpesh të diplomuar në shkolla të larta dhe të lidhur me idealet e lirisë dhe të përparimit. Në krahasim me atë bërthamë fillestare të lëvizjes xhonturke të vitit 1889, ndryshimet ishin tepër të mëdha. Militantët e Maqedonisë nuk ishin më studentë si më parë, por njerëz të rrahur nga jeta. Midis tyre tani mbizotëronin turqit. Edhe nga pikëpamja shoqërore ata tani ishin më homogjenë. Midis tyre nuk kishte më pashallarë, që ishin prishur me sulltanin, por njerëz nga klasa e mesme myslimane, të etur për të modernizuar perandorinë. Të gjithë ishin kundërshtarë të rreptë të ndërhyrjes europiane. Me një fjalë, mund të thuhet se më tepër se liberalë, ata ishin atdhetarë të vendosur për të shpëtuar Perandorinë Osmane.

Në vitin 1907 u zhvilluan disa takime midis Komitetit "Bashkim e Përparim", të cilin e drejtonte në Paris Ahmet Rizai dhe Komitetit të Selanikut. Në shtator të atij viti të dy organizatat vendosën të bashkohen. Ishte Komiteti i Selanikut ai që mori emrin "Bashkim e Përparim" dhe që filloi të dominonte lëvizjen: qendra e rëndesës e së cilës u zhvendos nga kryeqytetet evropiane në Selanik. Nga ana tjetër, po atë vit, në Paris u mblodhën në kongresin e dytë xhonturk grupet e Ahmet Rizait dhe të Sabaudinit, si dhe militantë armenë të partisë Dashnak. Gjithnjë e më tepër po fitonte terren ideja për një kryengritje të armatosur. Në gjithë perandorinë po keqësohej gjendja shoqërore dhe ekonomike.

Shqetësimin e përgjithshëm e shtuan edhe zhvillimet e tjera diplomatike. Afrimi anglo-rus, i cili u përvijua në vitin 1907, kur bëhej fjalë për Persinë, Tibetin dhe Afganistanin, u bë më i qartë kur car Nikolla II dhe mbreti Eduardi VII u takuan në Reval, në qershor 1908. Bisedimet e tyre u mbajtën të fshehta, por opinioni publik osman shqetësohej se mos bëhej fjalë për një copëtim të mundshëm të perandorisë. Në këtë mes propaganda gjermane dhe austriake hidhte benzinë mbi flakë, duke lënë të nënkuptohej se të dy sovranët kishin biseduar për një copëtim të tillë. Xhonturqit u vunë me shpatulla pas murit. Duhej të kalohej menjëherë në veprime, për të rivendosur Kushtetutën, por edhe për t'i dalë para shpërbërjes së mëtejshme të shtetit osman.[5]

Më 3 korrik 1908, Nijazi Bej Resnja dhe njerëzit e tij, duke përfituar nga fakti se oficerët në garnizon ishin në namazin e xhumasë morën armët, municionet dhe paratë e nevojshme dhe shkuan në mal. Ata që u ngjitën në mal ishin rreth 200 ushtarë, si dhe po aq bashibozuk dhe civilë. Arsyeja se pse ai mori edhe civil me vete ishte se ai mendoi që të krijonte një administrate që do të mblidhte taksat dhe do të zbatonte drejtësinë në mal.[6] Kështu filloi Revolucioni Xhonturk.

I. 1. Kontributi i shqiptarëve

Të bindur se Sulltani që përkrahej e mbështetej nga Fuqitë e Mëdha nuk do t'ia jepte asnjëherë Shqipërisë të drejtat që ajo kërkonte, shumë personalitete shqiptare të asaj periudhe menduan të bashkëpunojnë me Lëvizjen e Turqve të rinj, që kishte filluar në çerekun e fundit të shek. XIX, luftën kundër regjimit shtypës e reaksionar të Sulltan Abdyl Hamitit. Në Kongresin e parë xhonturk, në shkurt të vitit 1902, në Paris do të merrte pjesë si delegat i shqiptarëve të Kostancës dhe të Bukureshtit Jashar Erebara. Dihet se në këtë kongres u ftuan

[4] *Po aty,* f. 532.
[5] *Po aty*, f. 533.
[6] Smakaj, Gentrit. 2024. "Ndikimi i revolucionit xhonturk në nacionalizmin Shqiptar". Revista *Kosova* (48). Prishtinë, Kosovë, f.27-29. E qasshme në platformën online ACADEMIA më 01.10.2025: https://doi.org/10.62609/ks.v48i48.3715.

edhe armenë, grekë dhe arabë. Shqiptarët në këtë kongres u përfaqësuan nga Ismail Qemali, Dervish Hima, Kadri Prishtina dhe Jashar Erebara. Me 5 janar 1902 Jashar Erebara e njoftonte Ibrahim Temon se po nisej për në Paris dhe, pak ditë më vonë, e njoftonte se ishte takuar me organizatorët e Kongresit, princin Sabahudin dhe Ahmet Rizain.[7]

Delegatët shqiptarë në Kongresin e Parisit e mbrojtën me forcë çështjen shqiptare. Ismail Qemali nguli këmbë që përfaqësuesit e kombësive joturke të njiheshin si grupe kombëtare dhe të formuloheshin kërkesat e tyre. Ai e kundërshtoi programin e turqve të rinj, të cilët qenë për një pushtet të centralizuar, që në fakt ua mohonte të drejtat politike kombësive të tjera që bënin pjesë në Perandorinë Osmane. Në këtë kongres foli edhe Jashar Erebara, i cili theksoi se populli shqiptar gjerë më sot i ka bërë shumë shërbime të vlefshme qeverisë osmane, për të cilat asnjë shpërblim nuk ka marrë. Ai shtonte se populli shqiptar kërkon të drejtën e mësimit dhe të përdorimit të gjuhës shqipe në viset shqiptare të katër vilajeteve, njohjen e zakoneve shqiptare dhe njohjen e ekzistencës së popullit shqiptar.[8]

Gjatë ditëve të punimeve të Kongresit ai i shkruante vazhdimisht Ibrahim Temos për të informuar. Me 7 shkurt e njoftonte: Kongresi po vazhdon, ka bërë tri mbledhje, mund të bëjë edhe dy të tjera[9]. Mendimet tona të atyshme (Bukureshtit, K. F.) mbetën jashtë programit. Nga punimet e Kongresit të Turqve të Rinj, Erebara mbeti i zhgënjyer.

Rritja e vetëdijes kombëtare në Shqipëri në fillim të shekullit XX, përkoi me zhvillimin e lëvizjes xhonturke në Perandorinë Osmane. Në rrugën e realizimit të synimeve të kësaj politike, Lëvizja Kombëtare Shqiptare sigurisht që do të takohej me lëvizjet xhonturke, dhe kështu ndodhi. Intelektualët shqiptarë argumentojnë për arsyen që u bashkuan me xhonturqit për shkak të luftës kundër regjimit absolutist të Sulltan Abdylhamitit II. Pas mbylljes së parlamentit dhe shfuqizimit të kushtetutës, autoritetet osmane jo vetëm shkelnin të drejtat e shqiptarëve të fituara deri në atë kohë, por edhe përndiqnin e ndëshkonin shqiptarët myslimanë që lexonin dhe shkruanin gjuhën e tyre. Intelektualët shqiptarë i kushtuan rëndësi gjuhës amtare për të mbajtur gjallë kombin e tyre kundër lëvizjeve ndarëse pansllaviste dhe panheleniste në Ballkan. Ata u përpoqën të përhapnin gjuhën shqipe. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX aplikuan pranë Portës së Lartë për të hapur shkolla në gjuhën shqipe. Meqenëse Porta e Lartë nuk lejoi hapjen dhe zhvillimin kulturor të shkollave në gjuhën shqipe, intelektualët dhe patriotët shqiptarë iu bashkuan lëvizjes xhonturke. Me fjalë të tjera intelektualët shqiptarë që ishin kundër politikës së Sulltan Abdyl Hamitit, u bashkuan me lëvizjen xhonturke.[10] Ishte efektive për bashkimin e tyre në shoqëri ideja se shqiptarët do të fitonin të drejtat që do ta çonin Shqipërinë drejt pavarësisë nëse do të bëhej revolucioni kundër Sulltanit. Prandaj shqiptarët fillimisht dolën në anën e princit Sabahattin dhe miqve të tij që mbronin idenë e decentralizimit të Perandorisë Osmane. Këto personalitete ishin: Ibrahim Temo,*** Dervish Hima, Ismail Qemali, Hamdi Ohri, Nexhip Draga, Shahin Kolonja, Mithat Frashëri, Hoxha Kadri Prishtina, Jashar Erebara, Syrja Vlora etj. Shqiptarët, të cilët morën pjesë edhe në kongreset xhonturke, morën anën e princit Sabahattin. Në këtë mënyrë shpresohej që Shqipëria të fitonte një status autonom duke zbatuar programin e "decentralizimit".

Kërkesat e reja të shpallura nga xhonturqit në ditët e para të kryengritjes së korrikut ishin të përshtatshme edhe për shqiptarët. Lëvizja mendohet se ka çuar në bashkëpunimin e komiteteve "Për Lirinë e Shqipërisë" dhe xhonturqve. Grupet e armatosura të Çerçiz Topullit dhe Mihal Gramenos, të cilët luftonin prej kohësh në Shqipërinë e Jugut, u bashkuan me Nijazi beun, i cili filloi revolucionin. Nga takimi në Pogradec, njerëzit e Nijazi beut u shfaqen si përkrahës të çdo lloj kompromisi dhe pranuan kërkesat e shqiptarëve për autonomi. Kuvendi i Ferizajt ishte

[7] Gazeta "*Flaka e Vëllazërimit",* 24.7.1991 - Ruzhdi Mata: Kush është Jashar Erebara ?, f. 13.
[8] *Po aty*.
[9] *Po aty*.
[10] Smakaj Gentrit. *Ndikimi i revolucionit*…, f. 29.
***__Ibrahim Temo__ ishte student shqiptar nga Struga dhe njëri ndër themeluesit e parë të Shoqërisë Osmane për Bashkim (1889), e cila më vonë do të shndërrohej në Komiteti "Bashkim dhe Përparim" (*Ittihat ve Terakki Cemiyeti*).

pika më vendimtare e lëvizjes xhonturke dhe padyshim që mbështetja më e madhe civile për xhonturqit erdhi nga ky kuvend. Me votimin dhe betimin për realizimin e Programit të aprovuar, Kuvendi i Ferizajt më 20 korrik të vitit 1908 ia dërgoi Sulltanit një telegram ultimativ, duke kërkuar kthimin e Kushtetutës së vitit 1876 dhe ribërjen e Parlamentit. Sulltan Abdyl Hamiti II do të binte dakord që më 23 korrik 1908 ta shpallte kushtetutën. Kjo ngjarje shënoi edhe fitoren e Revolucionit Xhonturk të korrikut të vitit 1908, në të cilin shqiptarët dhanë një kontribut të rëndësishëm.[11]
Turqit e rinj dhe shqiptarët luftuan së bashku kundër Sulltan Abdyl Hamitit II deri në shpalljen e Monarkisë së Dytë Kushtetuese. Por, qëllimi i luftës së përbashkët ishte që të dyja palët ta shohin rendin kushtetues si një terren të përshtatshëm për zhvillimin e kombeve të tyre. Prandaj, marrëdhëniet mes palëve u dobësuan pas shpalljes së kushtetutës. Qëllimi përfundimtar i nacionalistëve shqiptarë për t'i mbështetur turqit e rinj ishte dhënia e statusit të autonomisë, andaj ata vazhdimisht parashtronin realizimin e reformave dhe autonominë administrative si parakusht gjatë regjimit të ri.

I. 2. Themelimi i klubeve shqiptare

Shpallja e monarkisë së dytë kushtetuese më 23 korrik 1908, u prit me gëzim dhe entuziazëm në të gjithë Shqipërinë. Fillimi i regjimit të Komitetit "Bashkim dhe Përparim" i gjeti shqiptarët shumë aktiv. Menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, u krijuan klube shqiptare kombëtare në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe në disa qendra të tjera të Perandorisë Osmane ku banonin shqiptarë.[12]
Pas shpalljes së Kushtetutës, xhonturqit nuk kishin pozita të sigurta në pushtet. Prandaj, ata në fillim duhej të mbanin raporte të mira me popujt tjerë, ndër ta edhe me shqiptarët. Në këto rrethana, në muajt e parë pas fitores së revolucionit pati një periudhë më liberale, nga e cila përfituan edhe shqiptarët duke themeluar klube kulturore.
Brenda një kohe të shkurtër u krijuan shumë klube me emrin "Bashkimi". Sipas Gentrit Smakajt numri i tyre kaloi 40-të.[13] Sipas disa burimeve tjera të ndryshme, vetëm brenda 10 muajve të parë u krijuan 66 klube kulturore dhe politike në krahinat shqiptare. Brenda kësaj periudhe u mbajt edhe Kongresi i Manastirit ose ndryshe i njohur si Kongresi i Alfabetit.[14]
Me nxitjen e patriotëve shqiptarë në gusht-shtator 1908 u krijuan klube në qytetet tjera, si: Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkup, Stamboll, Selanik, Janinë. Ndër klubet e krijuara, klubet *"Bashkimi"* u bënë qendrat më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Synimi i dukshëm i këtyre klubeve ishte mësimi dhe përhapja e gjuhës shqipe, por synimet fillestare të shoqërive shqiptare ishin krijimi i ndjenjës dhe bashkimit kombëtar midis shqiptarëve.
Më 31 korrik 1908 u themelua klubi *"Bashkimi"* i Manastirit, i cili ishte klubi i parë shqiptar dhe nën shembullin e tij vizionar u themeluan edhe klube të tjera gjithandej trojeve shqiptare.[15]
Disa ditë pas klubit të Manastirit, u themelua edhe Klubi *"Bashkimi"* i Shkupit, në fund të gushtit 1908, me angazhimin e elitës politike dhe atdhetare të shquar të vilajetit të Kosovës, dhe atdhetarëve të Shkupit, e të rretheve të tij. Ishte klubi i parë politik shqiptar që u themelua në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës. Për këtë ngjarje me interes u angazhuan Hasan Prishtina, Bajram Curri, Nexhip Draga, Bedri Pejani, Salih Gjuka, Halim Gostivari, Sali Nail Tetova, si dhe atdhetarë shkupjanë, si: Hamdi efendiu, Emin bej Kumbaraxhiu, Sait Idriz Hoxha, Beqir efendiu, Hafiz Ibrahim efendiut, Rrok Berisha etj. Një ndihmesë për këtë dha edhe delegacioni

[11] Smakaj Gentrit. *Ndikimi i revolucionit*…, f. 33 -34.
[12] Skëndi Stavro. 2000. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, Tiranë: PHOENIX, f. 313-314.
[13] Smakaj Gentrit, *Ndikimi i revolucionit, …,* f.37.
[14] Smakaj Gentrit. 2024. *Komiteti "Bashkim dhe Përparim" dhe shqiptarët në vitet 1908-1912*. Tiranë: Studime Historike - ASHSH, f. 63.
[15] Demiri Sevdail. 2017. *Variacione historike*. Shkup: SHHSHM, f. 10.

i atdhetarëve të Shqipërisë së Jugut, i përbërë nga vëllezërit Bajo e Çerçiz Topulli dhe Shahin Kolonja, të cilët për këtë synim qëndruan në Shkup disa ditë.[16]

II. Themelimi i klubit shqiptar të kumanovës

Klubi "Bashkimi" i Shkupit në fillim nuk kishin menduar që të zgjeroheshin edhe më tutje, mirëpo për pak kohë të shkurtër e ndjenë si obligim kombëtar hapjen e klubeve shqiptare edhe në vende tjera brenda vilajetit të Kosovës. Në fund të vitit 1908 dhe në gjysmën e parë të vitit 1909, me angazhimin e gjithanshëm të Pleqësisë së klubit "Bashkimi" të Shkupit, si dhe atdhetarëve të qyteteve të Vilajetit të Kosovës, u ngritën klube të tjera edhe në Kumanovë, Gjakovë, Mitrovicë, Vushtrri, Tetovë dhe Preshevë. Në janar të vitit 1909, me nismën e Pleqësisë së klubit "Bashkimi" të Shkupit, dhe të anëtarëve të tij, si: Qemal dhe Emin Kumbaraxhiu, Hajdin Draga, Rrok Berisha, Luigj Naraçi, Bedri Pejani, si dhe me angazhimin e Jashar Erebarës dhe Kajmekamit të Kumanovës u ngrit klubi "Bashkimi" i këtij qyteti, në fillim të shkurtit 1909.[17] Në hapjen e Klubit, Erebara u foli të pranishmëve, duke theksuar: *"...Kombi jonë është në rrezik. Shkollat e hueja po na bajnë shumë të kqija...Për me mujt me jau ndalë turrin këtyre të kqijave e nisum ta bajmë këtë klub shqiptar. Qëllimi ynë është të çelim shkolla e ta mësojmë popullin në gjuhën tonë. Kjo është dëshira e çdo shqiptari, dhe këtë dëshirë duhet ta mbushim".*[18]

Nga dokumentet arkivore kemi parë se kajmekami i Kumanovës, Nexhib Pashë Pejani e kishte përkrahur këtë nismë pa hezitim. *"Kajmekami, Nexhib Pashë Pejani, ashtu si edhe parija e vendit, sado që ndodheshin kohë kritike, nuk e penguan fare këtë vepër patriotike të ztr. Jashar Erebarës."*[19]

Në bazë të ndikimit të Klubit Bashkimi të Manastirit dhe të Klubit Bashkimi të Shkupit në formimin e këtij klubi mendohet që edhe ky klub të jetë quajtur Bashkimi edhe pse në vulën e këtij klubi qëndron vetëm mbishkrimi "Klubi Shqiptar" i shkruar në shqip, turqisht dhe arabisht.

Qëllimi i këtyre klubeve, ishte që nëpërmjet bashkimit të shqiptarëve në planin arsimor dhe kulturor, të arrihet deri te bashkimi kombëtar.[20]

"Nisjatori, vepruesi dhe mësuesi i këtij klubi ishte zotëri Jashar Erebara, me anëtarë Ismail Çaushin prej Tirane, Qazim Sejdinin prej Elbasani (kapiten në ushtrinë turke), Galip Kumanova dhe të tjerë kumanovas, si dhe Shaqir Gjakova (tregtar), Haxhi Ibrahimi (tregtar) dhe Bajram Aga Vranja. Qëllimi i klubit ishte me mësue, me këndue dhe me shkrue gjuhën shqipe, dhe për këtë arsye u organizue një shkollë nate. Menjëherë, më shumë se 30 nxënës të vegjël filluan me e ndjekë këtë kurs, dhe brenda një kohe të shkurtë numri arrit në 90 veta, të cilët filluan me shkrue e me këndue gjuhën amtare".[21]

[16] Abdyli, Ramiz. 2021. *Veprimtaria e Klubit të Shkupit (1908-1912)*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, f. 17.
[17] *Po aty*, f. 22.
[18] Fetahu, Adil. 2018. *Rilindasi i Llapit: Jashar Erebara,* Portali online Pashtriku, f. 1.
E qasshme në internet më 12.10.2025. https://pashtriku.org/adil-fetahu-rilindasi-i-llapit-jashar-erebara/
[19] Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH). Tiranë. Fondi (më tej: F) 23, Dosja (më tej: D) 71, fleta 2.
[20] Demiri, Sevdail, *vep. cit.*, f. 14.
[21] AQSH, Tiranë, F: 23, D: 71, fleta 1.


MBRETNIJA SHQIPTARE
BIBLIOTEKA KOMBËTARE
TIRANË
KLUBI SHKIPETAR
Tiranë, më..... 194...-XIX
1
Vula e Klubit Shqipetar
& Komanës (1909-1910)
Kjo vulë u perdorë në Komanovë në
vilajetin e Kosovës.
Ni sjalori, vepruesi i esht mësuesi i këtij
Klubi ishte Zot. Jashar Erebara, me antar
Ismail Qemalin prej Tiranet, dt. Rozvin Sejdinin
kapidan në ushtrin turke dhe të Tjatë Komanovas
si Shaqir Jakoven (tregtar) Hakki Ibrahimin
(tregtar) dhe Bajram ~~Agen~~ Lifaraj Oqa i
ushteris.
Qellimi i Klubit ishte me mësue
me kindue dhe me shtrue gjuhen shqipe, dhe po per
kët arsye u organizue nji shkollë natë –
Me nji leta, nua ohum se do m xansa të vejsil
fillimen me mbjekë kët kurs, dhe urenda nji koleo

1. **Dokument i dorëzimit të vulës së Klubit Shqiptar të Kumanovës në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare**

II. 1. Funksionimi dhe organizimi i tij

Kryetar i këtij klubi, për një kohë u zgjodh Jashar Erebara - atdhetar dhe publicist i njohur.[22] Mirëpo nga dokumentet e kohës shohim se përveç Erebarës në këtë shkollë ishte i angazhuar edhe një mësues tjetër shqiptar me përkatësi fetare ortodokse, Anastas Arnaudovi, pasi që pak kohë pas hapjes së klubit përmendëm se ishte hapur edhe shkolla e natës e cila funksiononte në kuadër të këtij klubi. "*Në këtë kurs nate, përveç Jashar Erebarës, që ishte shpirti i kësaj lëvizje shqiptare, ndodheshte edhe një mësues tjetër, një rekas, A. Anastasi, që mësonte edhe në shkollën bullgare të vendit. Me të vërtetë, popullsia qytetare bullgare simpatizonte këtë lëvizje shqiptare, por* serbët *jo, dhe shikojshin si e tek me e pengue, tuj u tregue autoriteteve turke aktivitetin e shqiptarëve."*[23]
Në dokumentet tjera përmenden disa nga nxënësit që kishin mësuar në këtë shkollë. *"Në këtë klub ka mësue Abdullah H. Saraçi – toger i xhandarmërisë dhe i vëllau Ahmed – polic në kryeqytete. Në klub mësojshin afër 120 shqiptar muhamedan se të krishterët ishin bullgar".*[24]
Për funksionimin e kësaj shkolle e këtij klubi përkujdeseshin popullsia vendase e qytetit të Kumanovës. Në një shkrim të dokumentuar thuhet se: *"Shpenzimet i paguanin vendalit."*[25]
Klubi *"Bashkimi"* i Kumanovës synonte ndërgjegjësimin kombëtar të anëtarëve dhe të pjesës tjetër të popullsisë së asaj krahine, përmes leximit të literaturës me përmbajtje kombëtare, e cila sigurohej nga kolonitë e mërgimit në Bullgari dhe në Rumani. Për furnizimin e klubit me libra u angazhua edhe klubi "Bashkimi" i Manastirit.[26]

[22] Abdyli Ramiz, *vep. cit.*, f. 22.
[23] AQSH, F: 23, D: 71, fleta 2.
[24] AQSH, F: 23, D: 45, fleta 4.
[25] AQSH, F: 23, D: 45, fleta 6.
[26] Abdyli Ramiz, *vep. cit*., f. 23.

Një nga arritjet më të mëdha ishte hartimi dhe botimi i abetares së njohur *"ABECEJA SHQIPE"* e Kumanovës, e cila, edhe pse pa siglën e autorit, shumë studiues janë të mendimit se bëhet fjalë për Jashar Erebarën.[27] Në një letërkëmbim mes Jashar Erebarës dhe Iljaz Agushit, të datës 10 tetor 1911, Erebara shkruan: *"Duke pasur parasysh nevojën për një abece shqype, po ju dërgoj disa copë me shpresë që do t'i dërgoni aty ku do ketë nevojë..."*. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha abetaret e kësaj periudhe kishin përmbajtje patriotike me qëllim të ngritjes së vetëdijes kombëtare. Ato ishin përpiluar sipas principeve të interesit kombëtar dhe dalloheshin me porositë e qarta edukativo-arsimore.[28]
Pas Kongresit të Manastirit dhe të Elbasanit, numri i abetareve u rrit dukshëm. Atëherë filluan të përpilohen abetare me Alfabetin e Manastirit. Shpërndarja e tyre bëhej me kujdes. Ato arrinin jo vetëm në vendet ku hapeshin shkollat, por edhe në ato vende ku nuk kishte shkolla. Kjo mundësonte organizimin e kurseve për fillestarë të mësimit të shkrim-leximit në gjuhën shqipe. "*Abeceja shqype*" e Kumanovës ishte një libër shkollor i përpiluar nga publicist Jashar Erebara. Këtë abetare e kanë përdorur shumë nxënës dhe të rritur jo vetëm në krahinën e Kumanovës, por dhe në shumë vende të Kosovës dhe me gjerë. Si e tillë, ajo llogaritet ndër abetaret e para, që e kanë kryer me sukses misionin e saj dhe ka ndihmuar në arsimimin fillestar në gjuhën shqipe.[29]
Abetarja kishte format të një fletushke me dimensione 38x40 cm, e shkruar në njërën faqe, e ndarë në tre pjesë dhe e radhitur në katër kolona. "*Abeceja shqype*" do ketë arritur në Kumanovë nga fundi i vitit 1911, që do të thotë se në të njëjtën kohë kur botohej edhe gazeta "SHKUPI".[30] "Abeceja shqipe" e Kumanovës përfshinte 30 njësi mësimore, nga të cilat 12 i përkisnin abetares dhe 18 ishin pjesë leximi.[31] "*Abeceja shqype*" e Kumanovës, ka një kompozicion të njëjtë me abetaret e para të kësaj periudhe. Abetarja ka gjithsej tre njësi tematike. Në fillim paraqiten shkronjat e shtypit dhe ato të shkrimit, më pas vijnë ushtrimet, përmes të cilave lidhen shkronjat me fjalët dhe fjalitë.[32] Nga studimi "*Abeceja shqype"-(Abetarja e Kumanovës, 1911*" e studiuesit Ardian Limani, prej pjesës së parë, pas shkronjave e zgjatimeve, nxjerrim një pjesë të tekstit:

Aneks:
N'o çdo mosh t'jesh për nji jav shqipen e mson dh'e shkruanë
** * **

Copa kndimesh

Ko-so-va asht pje-sa maa e bu-ku-ra e maa e hiesh-mja e Shqypnies, por per fat t'zii ven-da-sit e Ko-so-ves, qi ja-ne t' thjeshte Shqyptare, kan me-tun shum mas ko-he di-tu-nnit, e saa-do tri-ma e bu-rra, s'kan muj-te me na-lun ho-vin t'huej-vet, qi jane fu-te nder vende t-ona e sot ber-ta-sin e shkall-mo-hen si i-shin t'zott e ktij vendi, tuej e thi-rre kush Sta-ra Ser-bii e kush tuej lak-mue me e daa Shqupni-jet per me e bashkue me Maqedonii, n'uz-da-je se kshtu me e han-ger saa maa pa-re. E Shqyptaret t'zott e Ko-so-ves çka bajnë? As-gjaa, por flejne e gjinden aq poshte sa nuk kan kurr-nji shko-lle n'guhe t'vet, e pak fort jan a-ta qi dijnë me kendeu guhen Shqy-pe. E kshtu tuaj voi-tun punet çka do t'ndo-lli: Gja-set jan fort t' kqija per komm t'Shqaptarit por n'mos u çofshum pre-je gjumit.

[27] Demiri, Sevdaili, *vep. cit.,* f. 17.
[28] Limani, Ardian. 2020. "Abeceja shqype"- (Abetarja e Kumanovës, 1911). Në *Studime Albanologjike 20*. Shkup: ITSHKSH, f. 378.
[29] *Po aty.*
[30] *Po aty*, f. 376.
[31] Demiri Sevdail, *vep. cit.*, f. 18.
[32] Limani Ardian, *vep. cit*., f. 377

II

A asht fot i motshem komi i Shqyptarit? Komi i shqyptarit asht nder dhena t 'Ballkanit maa i vjetri e perpata atij s'permendet kurr-nji koom tjeter. Aq i vjeter Shqyptari ass historija nuk mund t'na diftojne se kuer kemi ardh nder kto vende. Disaa thon se kemi ardhe nder kto ana n'kohe t'Azreti Ibrahim, don me thane tash nja kater-mii vet.

A kemi pase ndo-nji here ditunii?

Jo, s'kemi pase kurr e per ket arsye jami farue e kemi mete fort pak, pse dikues Mali i Zi, Her-ce-go-vi-na, Bosnja, Serbija, Bullgaria e maa pertej deri nder dhena t'Austries, kan pas kene toke Shqyptare, por sot s 'jane maa, pse na i kan ngrane t'huejt, qi na gjeten liksht paa knim paa shkrim.

Ç' fare guhet kemi?

Kemi nji guhe fort t'vjeter, por edhe fort t'bukur; guha jon asht moter me guhe t'Persies (t' Axhe-mi sta-nit) e me guhe tjera t'Europes, si me guhe t' Latinvet e t'Allemanjes. Kush e kaa msue e e ngjef guhen shqype mir e shef se asht fort e bukur e njani tuej e paa kaq t'hieshme pat thane se Perendija do t'keet fole shqyp me nierin e pare, me Azreti Adem. Edhe ndoshta ja kaa qillue mire. Po na Shqyptar a e domi guhen t'one? Me marre t'madhe na duhet me than se nuk e domi aspak guhen t'one e me zi ç'presim me u kape per guhe t'hueja e per kadale vime tuej harrue guhen t'one e mas pak motit djelmt t'one nuk dijen me fole maa shqyp, edhe pse jane Shqyptare. Oh saa korii e madhe per nee! Saa faqe t'e zeza!

III

Ku gjindet Shqypnija?

Shqypnija gjindet n'Europë, kahe juge t'leemit, nder ata dheena, qi thirren tbashkutdheenat e siujdhazes ballkane.

Çka don me thane siujdhaze?

Siujdhaze thirret nji dhee, qi asht i rrethuem gati gjith kahe me deed; po n' kofte e rrethuem gjithkahe me deed atejere thohee ujdhaze a se ishull.

Ç'fare tjera dhënash gjinden n' siujdhaz ballkane?

Pose Shqypnijet n'siujdhaze ballkane gjinden edhe kta dhena: Makedhonia, Thrakija, Mali i Zi, Bosnja me Hercegovine, Serbija, Bullgarija, Rumanija e Graqija.

Ç'fare komesh gjinden ne siujdhaze ballkane?

Nder kome t' siujdhazes ballkane zen venden e pare, pse maa i vjetri, komi shqyptaar, mandje vine Grakt, Rument (Goge a se Vllah), Bullgarat, Serbt, Jahudiie e pak Gabel e Magjype.

Saa detna e lagin siujdhazen ballkane?

Siujdhazen ballkane e lagin shum detna: deti Adriatik, deti Jon, deti Mejsdhee, deti Egjee, deti Marmara, deti i Zii.

Shqypnija me ka mahet?

Shqypnija mahet me Turkii.

Çka asht Turkija?

Turkija asht nji pushted. Pushtede don me thane nji a disa dhena qi sundohen bashkarisht a ndryshe, qi kan nji qeverii bashkarisht. Turkija asht nji pushted e madhe e shtrihet n'Europe, n'Azii e n'Afrike, por pjesa maa e madhe gjindet n'Azii.

Q'fare sundimit kaa Turkija?

Turkija sod per sod kaa nji sundim fort t'bukur. Mreti urdhnon e sundon tuej povete popullin, don me than qi Mreti o populli sundojne bashkarusht, nuk punon asgjaa paa u marre vesht nder vedi: Mreti kaa njerst t'vett e thirren deputet, qi do t'shkojne n'Stamolle per m'u permledh e z'bashkut me shikue punet e sindimit. Vedni ku mlidhen deputetent thirret Parlament.

Sa ministra kaa mreti per me sundue?

Mreti per me sundue kaa 13 ministra, nder t'cillet Sadriazemi asht kryetaar. Ky fare sundimi turqisht thohet kanunu esasee e shqyp thohet Konstitucion.[33]

Veprimtaria e këtij klubi përkrahej nga populli shqiptar, nga qarqet bullgare konkretisht nga konsullata bullgare ndërsa i pengonte qarqeve serbe. Konsulli serb në Shkup, hidhte gurë e dru mbi klubin e Kumanovës, duke e parë veprimtarinë e tij të rrezikshme për interesat e vendit të tij.
Në fillet e para të këtij klubi, drejtimin e klubit e kishte për një kohë të shkurtër kapiteni Qazim Elbasani dhe mësonin të gjithë nxënësit shqiptar të qytetit dhe kazasë. Jashar Erebara i porosiste vazhdimisht që ta mësojnë gjuhën e tyre dhe të punonin që të bëhet Shqipëria etnografike se përndryshe këto vende do t'i merrte Serbia.[34]
Pas fitores së lëvizjes xhonturke, siç e përmendëm më lartë, xhonturqit nuk kishin pozita të sigurta në pushtet, e ata në fillim duhej të mbanin raporte të mira me popujt tjerë, ndër ta edhe me shqiptarët. Në këto rrethana, në muajt e parë pas fitores së revolucionit pati një periudhë më liberale, mirëpo më pas filloi një fushatë e egër për mbylljen dhe shkatërrimin e gjithçkaje që nuk thirrej në emër të osmanizmit por në emër të nacionalizmave. Nga kjo fushatë u arrestuan e u përndoqën të gjithë rilindësit që jepnin mund dhe kontribut për ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare, klubet u shpallën si të jashtëligjshme dhe jetëgjatësia e këtij klubi nuk ishte edhe shumë e gjatë.
Në këto rrethana kryetari Jashar Erebara, mirëpo në emër të klubit "Bashkimi" të Shkupit, më 6 gusht 1911, i shkruan një letër/kërkesë Komitetit Qendror të partisë Ittihat e Terakki në Stamboll në të cilin kërkonte bashkëpunimin e elementit turk me elementin shqiptar për mbrojtjen e territorit shqiptar të Perandorisë Osmane nga synimet e vendeve ballkanike për copëtuar Shqipërinë. Ai shkruante se kombi shqiptar kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, me vetëdije, për ngritjen e osmanizmit e veçanërisht për atë që revolucioni xhonturk të kishte sukses dhe të rrëzonte despotizmin e atëhershëm, dhe si shkak-pasojë e kësaj duhej të kishte një bashkëpunim të pashmangshëm edhe më tutje duke bërë kështu që të ngrihej edhe më tutje nacionalizmi shqiptar si dhe të mbahej qëndresa osmane.

[33] *Po aty,* f. 378 -380.
[34] AQSH, F: 23, D: 45, fleta 2.



N ' oçdo mosh t ' jesh për nji jav shqipen e mson dh ' e shkruanë .

آرناؤودجه الفباسی

Abeceja Shqype

صدالی حرفلر

آل بازیسی اوفاق حرفلر:

Germa t ' zaashmo

t ' dorshkrueme t ' vogla:

a, o, u, e, i, y, ë.

آل بازیسی بیوك حرفلر

t ' dorshkrueme t ' mdhaja :

A O U E I Y E

مطبوع اوفاق حرفلر:

t ' shrypshkrueme t ' vogla:

a o u e i y e

مطبوع بیوك حرفلر:

t ' shtypshkrueme t ' mdhaja:

A O U E I Y E

اوفاق حرفلر آل بازیسی:

Germa t ' perzaashme

t ' dorshkrueme t ' vogla :

b c ç d dh f g gj h j k

g l ll m n nj p r u o sh

z zh t th v x xh.

آل بازیسی بیوك حرفلر :

t ' dorshkrueme t ' mdhaja :

B C D Dh F G

Gj H I K Q L

Ll M N Nj P

R Rr S Sh Z Zh

T Th V X Xh.

t ' zaashmo hundake :

بورندن كلان صدالر :

â ô û ê î y

t ' zaashmo t ' gjata :

na co nu ce ii yy

تعلیمات Ushtrime

ba bo bu be bi by; co co cu ce ci cy ; ça ço çu çe ci cy; da do dhu dhe fi fy; ga go gju gje bi hy; ka ko qu qe li ly; lla lle mu me ni ny; nja njo rru rre sha sho shu shi thy tha xho xhu.

Fjale t' daame n ' rok,e

ba-ba bu-ba cu-bi cu-ca çu ba da-da da-ci dhee dhou ca-fi cu-fi ga-ca go-ca g,e-li gje-dhi ho-be ha-bii go-ja gje-ja ko-ci ka-fi qa-fa qy-gi lu-gi lu-ga llu-lla ha-lla ma-li mo-ti na-ta nu-na nja-ni n,a-ça pi-pi pu-la ri-ka ru-ba rru-mi rri-ba sy-bi sa-ki-ra sho-sha she-sht zo-gu za-lli shu-ri zhe-le te-pi tu-lla thi-ka tha-na vo-shi vâ-thi va-ta xa-ri-sha xa-na xha-mi-ja xha-mi .

bar-ku dar-dha cub-ni-ja çer-dhe dhun-ti-ja far-ke-to-ri gar-gu-lli gjer-g,e-fi har-mi-ja jar-gu kan-ga qur-shi-ja luk-thi llam-pamar-ti nir-thi par-si-ja o-rum rrag-ni-ca sel-vi-ja shap thep var-gu xhur-di-je.

braçcile drum lardh filad grep gjergj hurp jarg kual qyrk larg mart nirth plep rrumth sert shumth trup tharmvremç.

shkrep shkyp shqimth grazhd grusht brisk agrigth kurneth.

n,i di-t:: shum dit; nji vesh dy ve-sh ; han ha-n ; lug lu-g ; n,i metelik dy metelik ; nn kam dyy ka-m ; nji na-t:: shum net; shok sho-k:; nji fi-je flok dyy fi-je flo-k ; plak pla-k:.

aar are nji ka-tun-daar dy ka-tun-da-re nji malcuer dy malcorë free pee syy g,aa drii.

تعلیم قرائت Copa kndimesh

I

Ko-so-va asht pje-sa maa e bu-ka-ra e maa e hiesh-mja e Shqypnies, per per fat t' zii ven-da-sit e Ko-so-ves, qi ja-ne t' thjesh te Shqyptare, kan me-tun shum mas ka-be di-tu-niit, e, maa-do tri-ma e bu-rra, s ' kan muj-te me na-lun ,ho-vin t' huej-vet, qi ja-ne fu-re nder vendo t ' o-na e sot her-ta-sin e shkall-mo-hen si i-shin t ' sott e ktii ven-di, tuej e thi-rre kush Sta-ra Ser-bii e kush tuej lak-mue me e daa Shqyp ni-jet per me e bashkue me Maqedonii, n ' un-da-je se kshtu me o han-ger sua maa pa-re .

E Shqyptaret t' zott e Ko-so-ves çka bajne ? As-gjaa, per flejne e gjinden aq poshte sa nuk kan kurr-nji shko-lle n ' guhe t ' vet, e pak fort jan a-ta qi dijne me kon-due guhen Shqy-pe . E kshtu tuej voj-tun punet çka do t ' ndo-llin ? Gja-sot jan fort t' kqi-ja per koom t ' Shqyptarit por n'mos u çofshim pre-je gjumit.

II

A asht fort i motshem komi i Shqyptarit ?

Komi i shqyptarit asht nder dhena t ' Ballkanit maa i vjetri e perpara atli s ' per-mendet kurr-nji koom tjeter . Aq i vjetor Shqyptari saa historija nuk mund t'na dif-tojne se kuer komi ardhe nder kto vende . Disaa then se komi ardhe nder kto ana n ' kohe t ' Azreti Ibrahim, don me thane tash nja kater-mii vjet .

A komi pase ndo-nji hero ditunii ?

Je, s 'komi pase kurr e per kot arsye jemi farue e komi mete fort pak, pse dikuer Mali i Zii, Her-ce-go-vi-na, Bosnja, Serbija, Bullgarija e maa pertej deri nder dhena t ' Austries, kan pas kene toke Shqyptaro, por sod s ' jane maa, pse na i kan ngrane t ' huejt, qi na gjeten likshtt paa knim paa shkrim .

Ç ' fare guhet komi ?

Komi nji guhe fort t ' vjeter, por edhe fort t ' bukur; guha e jon asht moter me guhe t ' Persies (t ' Axhe-mi sta-nit) e me guhe tjera t ' Europes, si me guhe t ' Latiavet e t ' Allemanjes. Kush e kaa msue e e ngjef guhen shqype mir e shef se asht fort e bukur e njani tuej e paa kaq t ' hi-eshme pat thane se Perendija do t ' keet fo-le shqyp me nierin e pare, me Azreti Adem. Edhe ndoshta ja kaá qillne mire.

Po na Shqiptar a e domi guhen t 'one ?

Me marre t ' madhe na duhet me than se nuk e domi aspak guhen t ' one e me zi ç ' presim me u kape per guhe t ' huejn e per kadale vime tuej harrue guhen t ' one e mas pak motit djelmt t ' one nuk dijen me fole maa shqyp, edhe pse jane Shqypta-re. Oh saa korii e madhe per nee ! Saa faqe t ' e zeza !

III

Ku g,indet Shqypnija ?

Shqypnija gjindet n' Europë ,kahe ju-ge t ' leemit, nder ata dhena, qi thirren t' bashkut dheenat e siujdhazes ballkane.

Çka don me thane siujdhaze ?

Siujdhaze thirret nji dhee, qi asht i rre-thuem gadi gjith kahe me deed ; por n ' kofte i rrethuem gjithkahe me deed atehere thohee ujdhaze a se ishull .

Ç ' fare tjere dhënash gjinden n ' siujdhaz ballkane ?

Pose Shqypnijet n ' siujdhaze ballkane gjinden edhe kta dhena : Makedhonija , Thrakija, Mali i Zii, Bosnja me Hercegovine, Serbija, Bullgarija, Rumanija e Greqija .

Ç ' far komesh gjinden n ' siujdhaze ballkane ?

Nder kome t ' siujdhazes ballkane zen venden e paro, pse maa i vjetri, komi shqy-ptaar, mandej vine Grekt, Rumeut (Gogo a se Vllah) , Bullgart, Serbt, Jahndilt e pak Gabel e Magjypo.

Saa detna e lagin siujdhazen ballkane ?

Siujdhazen ballkane e lagin shum de-tna : deti Adriatik, deti Jon, deti Mjesdhee, deti Egjee, deti Marmara, deti i Zii .

Shqypnija me ke mahat ?

Shqypnija mahet me Turkii.

Çka asht Turkija ?

Turkija asht nji pushtede . Pushtede don me thane nji a disaa dhena qi sundo-hen bashkarisht a ndryshe, qi kan nji qe-verii bashkarisht . Turkija asht n,i pushte-de e madhe e shtribet n ' Europe, n ' Azii e n ' Afrike, por pjesa maa e madhe gjin-det n ' Azii .

Q ' fare sundimit kaa Turkija ?

Turkija sod per sod kaa nji sundim fort t ' bukur. Mreti urdhnon e sundon tuej pu-vete popullin, don me than qi Mreti e po-pulli sundojne bashkarisht, nuk punojne asgjaa paa u marre vesht nder vedi : Mreti kaa njerst e vet qi thirren ministra edhe populli kaa t ' vett e thirren deputet, qi do t ' shko,ne n ' Stamolle per m ' u per-mledh e z ' bashkut me shikue punet e sundimit . Vendi ka mlidhen deputetent thirret Parlament .

Saa ministra kaa mreti per me sundue ?

Mreti per me sundue kaa 13 ministra, nder t ' cillet Sadriazemi asht kryetaar .

Si thirret ky fare sundimit, qi kaa Turkija ?

Ky fare sundimit turqisht thohet kanuni essaii e shqyp thohet Konstitucion.

2. **Faksimili i "Abeceja Shqype"**

"Pra qëndresa e otomanizmës jo vetëm në Evropë por edhe në Azi mund të bëhet me forcimin e vazhdimin e bashkimit të harmonishëm të elementit turk e shqiptar që është themeluar prej shekujsh e që me datën 10 korrik e shfaqën perfeksionimin e plotë të vet."[35]

"Çdo kush që ka pak njohuri mbi historinë" – vazhdonte Erebara,"*dhe e njeh pak situatën aktuale politike e kupton këtë realitet."*[36]

Erebara si element më të mire bashkëpunimi parashihte bashkëpunimin në mes shtresës elitare intelektuale osmane dhe asaj shqiptare për të mirën e përbashkët duhet hequr dorë nga veset e dëmshme që mbështeten në interesa e ambicie personale.

[35] AQSH, F: 23, D: 4, fleta 4.

[36] *Po aty*.

Pas betejës së Kumanovës[**], Kumanova dhe fshatrat e rrethit të saj ranë nën sundimin serb, prej këtu kishte filluar edhe përndjekja e të gjitha elementeve kombëtare në këtë qytet përfshirë këtu edhe ata që kishin qenë përkrahës të klubit shqiptar të Kumanovës.

"Mirëpo tani, serbët i akuzojnë shqiptarët se kemi gisht me agjentët shqiptar, se këtu në Kumanovë në kohën e Turqisë kemi pasur klub e shkollë shqipe. E nga ky shkak policia serbe ka burgosur Muharrem Shaqirin, tregtar nga Gjakova si dhe Ahmet Jakubin sahatxhiun- nga Presheva."[37]

Në vazhdim të këtij dokumenti shohim se ka pasur edhe arrestime tjera: *"Kan burgos edhe Arif Vehbiun të birin e muderrizit i cili kishte marrur pjesë edhe në Ligën e Prizrenit. Si po duket serbët vine me taktik me faros kombin shqipëtar nga Kosova."*[38]

Referencat

[1]. Arkivi Qendror i Shtetit, Tiranë (AQSH).
[2]. Abdyli Ramiz. 2021. *Veprimtaria e Klubit të Shkupit (1908-1912)*. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.
[3]. Demiri Sevdail. 2017. *Variacione historike*. Shkup: SHHSHM.
[4]. Fetahu Adil. 2018. *Rilindasi i Llapit: Jashar Erebara,* Portali online Pashtriku.
[5]. Limani Ardian. 2020. *"Abeceja shqype"- (Abetarja e Kumanovës, 1911)*.Shkup. ITSHKSH: Studime Albanologjike 20.
[6]. Mantran, Robert. 2004. *Historia e Perandorisë Osmane*- përktheu Asti Papa. Tiranë: Dituria.
[7]. Skëndi Stavro. 2000. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, Tiranë: PHOENIX.
[8]. Smakaj Gentrit. 2024. *Komiteti ,,Bashkim dhe Përparim,, dhe shqiptarët në vitet 1908-1912*. Tiranë: Studime Historike – ASHSH.
[9]. Smakaj, Gentrit. 2024. "Ndikimi i revolucionit xhonturk në nacionalizmin Shqiptar". Revista *Kosova* (48). Prishtinë, Kosovë.
[10]. Gazeta "Flaka e Vëllazërimit", Shkup.

Shkurtesa:

1. AQSH – Arkivi Qendror Shtetëror
2. ASHSH – Akademia e Shkencave Shqiptare
3. ITSHKSH – Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë
4. SHHSHM – Shoqata e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë

[**] **Beteja e Kumanovës** 23 – 24 tetor 1912, nga kjo betejë ushtria serbe depërtoi në trojet etnike lindore shqiptare pasi që e mposhti ushtrinë osmane.
[37] AQSH, F: 23, D: 45, fleta 2.
[38] *Po aty*, f. 3.